



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 735 Prot.

Tiranë, më datë 19.052021

VENDIM

Nr. 255, datë 19.05.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.05.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të Sondazheve Arkeologjike sipas konceptit të Sondazheve Arkeologjike në zonat me numër pasurie 6/44, 6/53 dhe 6/58, Zona Kadastrale 8210, pranë Mozaikut të Tiranës, miratuar me Vendim Nr. 156, datë 29.03.2021, realizuar nga IKTK/DSHA dhe DRTK Tiranë;
2. Kryerjen e konservimit të strukturave të zbuluara gjatë sondazheve arkeologjike, sipas një projekti të hartuar nga DRTK – Tiranë në bashkëpunim me IKTK;
3. Vijimin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në zonat ku janë konstatuar strukturat arkeologjike, të cilat janë vazhdim i ambienteve të Mozaikut (Vila Romake), përkatësisht në zonat me nr. Pasurie 6/44, 6/52, 6/53, 6/55, 6/58, 6/76, 6/83, dhe 6/381.
4. Të realizohet sondazhi arkeologjik në zonën me nr. Pasurie 6/111, ku është evidentuar potencial i lartë arkeologjik;
5. Gërmimi arkeologjik i shpëtimit dhe sondazhi, të realizohen nga DRTK - Tiranë;
6. Rezultatet e gërmimit arkeologjik të shpëtimit do të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje në mbledhjen e radhës së KKTKM;
7. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
8. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
9. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

